

Administrata e të ardhurave lokale publike e Komunës së Tuzit, me Konkludim numër 01-031/19-3348/1 dhe 01-031/19-3348/2 prej datës 14.06.2019, ka përcaktuar **Propozim Vendimin mbi taksat lokale administrative dhe Vendimin mbi taksat lokale komunale.**

Propozimi i vendimeve vihet në diskutim publik prej 15 ditëve, duke filluar më **14.06.2019** përfundimisht më datën **28.06.2019**.

PROGRAMI I DISKUTIMIT PUBLIK

Propozimi i vendimeve do të shpallet:

- në faqen e internetit të Komunës së Tuzit www.tuzi.org.me

Propozimi i vendimeve do të dorëzohet:

- këshilltarëve të Kuvendit të komunës së Tuzit dhe kujdestarëve të organeve të administratës lokale.

Diskutimi publik do të kryhet në formë elektronike, të shkruar dhe me gojë.

Diskutimi publik në formë elektronike organizohet me dorëzimin e vërejtjeve, propozimeve dhe sugjerimeve elektronike të qytetarëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në email adresën daniyella.gjelaj@tuzi.org.me gjatë gjithë periudhës së parashikuar për debat publik.

Diskutimi publik në formë të shkruar organizohet me anën e dorëzimit të vërejtjeve, propozimeve dhe sugjerimeve të shkruara të qytetarëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në adresën: Administrata e të ardhurave lokale publike e Komunës së Tuzit, Tuz p.n.81206, përfundimisht me ditën e përfundimit të diskutimit publik.

Diskutimi publik qendrorë do të mbahet:

- në lokalet e Kuvendit të komunës së Tuzit më **25.06.2019** me fillim në orën **11:00**.

Diskutimin publik do të zbatojë Administrata e të ardhurave lokale publike e Komunës së Tuzit, i cila me përfundim të së njëjtit do të hartojë raport mbi zbatimin e diskutimit publik me propozimet, vërejtjet dhe sugjerimet e pjesëmarrësve në të gjitha fazat e sjelljes së akteve dhe arsyet për mospranimin e tyre eventual, do të përcaktojë Propozimin e vendimeve dhe do ta dorëzojë Qeverisë së Malit të Zi në procedurë të mëtutjeshme.